



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR PLOTËSIMIN E 1 (NJË) POZICIONI PRANË  
MINISTRISË SË DREJTËSISË PËRMES PROCEDURËS SË KOMANDIMIT TË  
PROKURORËVE**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 166 pika 2, 184, 189 pika 1, gërma “b”, të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 53, pika 2 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 17.12.2020 me vendimin nr.294 vendosi fillimin e procedurave për komandimin e 1 (një) prokurori në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, **në Ministrinë e Drejtësisë.**

Këshilli fton të gjithë prokurorët e Republikës së Shqipërisë të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- të ketë ushtruar profesionin e magjistratit për të paktën 3 vite;
- përvoja në hartim aktesh si dhe në pozicione drejtuese, në rast se ka, do të vlerësohet pozitivisht;
- të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet Anglishtja);
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
- të ketë njohuri baze në përdorimin e kompjuterit.

të shprehin interesin për t’u komanduar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin brenda datës **05.01.2021, ora 16.30**, në adresën si në vijim: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.**

Kërkesa për shprehjen e interesit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4).
2. CV- në e kandidatit.
3. Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj.
4. Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm.

Mbi zarf duhet të shënohet: “Shprehje Interesi për Komandim pranë Ministrisë së Drejtësisë”.

**Mirëpresim aplikimet Tuaja!**